



Pranimi / Dorezimi Received / Delivery	13 - 10	2022	2	viti год year
Organ / Njësia Organ / Jediniца Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDM/SHIK	6160/2022		116	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.08/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, sipas Aktgjykimit A.nr.588/2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 17.12.2021, ka shqyrtuar ankesën numër A.nr.08/2020 të datës 13.01.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër Vendimin KZKA.nr.28/2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i datës 12.12.2019, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.10.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.08/2020 e datës 13.01.2020 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimin KZKA.nr.28/2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i datës 12.12.2019.

A r s y e t i m

Ankuesi, me datë 13.01.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit KZKA.nr.28/2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i datës 12.12.2019 me pretendimet ankimore se vendimi për refuzimin e ankesës së tij është i padrejtë dhe jo i ligjshëm, ndërsa në konkursin për pozitën e Drejtorit të Muzeut Kombëtar të Kosovës, kandidati është

përzgjedhur në mënyrë jo meritore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 22.01.2020 me numër protokolli ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa me datën 30.01.2020 me numër protokolli 226/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 26.02.2020 përmes Njoftimit me Nr.Prot:506/2020, ka njoftuar ankuesin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën A.nr.08/2020 të datës 13.01.2020, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar të njëjtin mbi të drejtën e inicimit të procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 17.12.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.558/2022, i cili në Këshill është pranuar me datën 16.09.2022, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, duke anuluar njoftimin e datës 26.02.2020 të KPMSHCK-se dhe ka obliguar Këshillin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesve me numër A.nr.08/2020 të datës 13.01.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesa A.nr.08/2020 e datës 13.01.2020 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimi A.nr. 588/2020 i datës 17.12.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi për anulimin e konkursit me nr.ref.2623/2019 e datës 23.08.2019; Njoftimi për zgjatjen e pranimit të aplikacioneve me nr.ref.3037/2019 e datës 16.07.2019; Njoftimi për pezullimin e konkurseve me nr.ref.4316/2019 e datës 11.10.2019; Vendimi KZKA NR.28/2019 i datës 12.12.2019; Ankesa drejtuar Komisionit për zgjidhjen e kontesteve në MKRS; Kërkesa për përgjigje në ankesë me nr.prot.189/2020 e datës 22.01.2020; Përgjigja në kërkesë me nr.prot.226/2020 e datës 30.01.2020; Përcaktimi i kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë me nr.ref.25/019; Përcaktimi i kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilën kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Përmbledhje e testeve individuale me nr.ref.25/2019; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues me nr.ref.29/2019 i datës 21.08.2019; Shkresë për kandidatët e ftuar për intervistë ref.25/2019; Shkresë për kandidatët e ftuar në test me shkrim; Shkresë për vazhdimin e intervistimit me gojë me nr.ref.3581/2019 e datës 22.08.2019; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për 5 faqe; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për 1-5 faqe; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për 1 faqe; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për 1-5 faqe; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për 1-5 faqe; Vendim nr.ref.876/2018 e datës 29.03.2018; Dëshmi e pranimit ref.25/2019 e datës 08.07.2019; Formulari i kërkesës për punësim për i datës 08.07.2019; Certifikatë e lëshuar nga MASHT dhe ICRC e datës 21-23.06.2008; Certifikatë e lëshuar për nga Kuvendi Komunal i Drenasit dhe QPEA e datës 08.10.2007; Certifikatë trajnimi e lëshuar për nga Learning Together; Certifikatë e lëshuar për nga OMEGA, Das Land



Steiermark dhe QPEA e datës 26.12.2008; Certifikatë e lëshuar për _____ nga ECDL Foundation dhe ECDL Kosova e datës 25.01.2011; Certifikatë e lëshuar për _____ nga CDRSEE; Certifikatë e lëshuar për _____ nga OMEGA dhe Das Land Stelenmark; Certifikatë e lëshuar për _____ nga USAID dhe FHI360 e datës mars 2013; Lista me konkurse; Certifikatë e lëshuar për _____ nga giz international services dhe Universiteti "Hasan Prishtina" e datë 11.2013-02.2014; Certifikatë e lëshuar për _____ nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Certifikatë e lëshuar për _____ e datës 25.11.2017; Certifikatë nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar nga gjykata për _____ e datës 12.06.2019; Diplomë lëshuar për _____ nga Universiteti "Hasan Prishtina", Fakulteti i Filozofik-Programi Master, nr. 314 e datës 5.02.2014; Diplomë lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik për _____ nr.862 e datës 04.07.2007; Kopja e Letërnjoftimit; Referencë për _____ lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Referencë e lëshuar për _____ nga Komuna e Drenasit e datës 26.02.2019; Rekomandim nr.ref.2312/2019 e datës 11.06.2019; Pasqyra e llogarisë në TRUST prej 01.08.2002-26.11.2019; Vërtetim për _____ lëshuar nga SHFMU "Bajram Curri" Nekoc, nr.428/2 e datës 05.07.2019; Dëshmi pranimit nr.ref 25/2019 e datës 11.07.2019; Formula e kërkesës për punësim për _____ e datës 11.07.2019; Kopje e Letërnjoftimit; CV për A.Arifi prej 1-6 faqe; Vendim nr.ref.6-263 e datës 18.01.2019; Vërtetim i kopjes nga Originali lëshuar nga Notere _____ LPR.nr.0169/2019 e datës 24.12.2018; Certifikatë për _____ lëshuar nga South-Ëest University "Neofit Rilski" për _____ nr.ref.49-00115 e datës 13.11.2018; Përkthim i Certifikatës lëshuar nga South-Ëest University "Neofit Rilski" për _____ nr.ref. 49.00.115 e datës 13.11.2018; Vërtetim i kopjes nga Originali lëshuar nga Notere _____ LPR.nr.4432/2018 e datës 17.12.2018; Kopje e kartelës për _____ Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris Sorbonne për _____ e datës 23.11.2009; ; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris Sorbonne për _____ e datës 14.05.2009; ; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris Sorbonne për _____ e datës 08.12.2008; ; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris Sorbonne për _____ e datës 28.04.2009; ; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris Sorbonne për _____ e datës 22.03.2011; ; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris Sorbonne për _____ e datës 24.03.2010; ; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris Sorbonne për _____ e datës 18.10.2010; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris IV Sorbonne për _____ Annee universitaire 2008/2009 "Attestation De Paiement"; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris IV Sorbonne për _____ Annee universitaire 2009/2010 "Attestation De Paiement"; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris IV Sorbonne për _____ Annee universitaire 2010/2011 "Attestation De Paiement"; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris IV Sorbonne për _____ Annee universitaire 2011/2012 "Attestation De Paiement"; Shkresë e lëshuar nga Universitet Paris IV Sorbonne për _____ Annee universitaire 2012/2013 "Attestation De Paiement"; Attestation De Reussite Au Diplome lëshuar nga Universitet de Grenoble 2 e datës 19.10.2007/ e përkthyer në gjuhën shqipe; Releve de notes, Annee 2005-2006, lëshuar për A.Arifi e datës 10.04.2006; Releve de notes, Annee 2006-2007, lëshuar për A.Arifi e datës 28.04.2007/ e përkthyer edhe në gjuhën shqipe; Releve de notes et resultats, Annee universitaire 2004/2005 lëshuar për _____ datës 17.10.2005/ e përkthyer edhe në gjuhën shqipe; Vërtetim i kopjes nga Originali lëshuar nga Notere _____ LPR.nr.0168/2019 e datës 24.12.2018; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik për _____ nr.325 e datës 22.03.2004; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për _____ e datës 15.02.2003; Vërtetimi i lëshuar nga Instituti i Kosovës për mbrojtjen e Monumenteve për _____ i datës 21.09.2018; Certifikatë e notave lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik e datës 14.12.2006, me numër të dosjes 485; Akt emërimi për _____

i lëshuar nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore e datës 28.12.2010; Kontratë e marrëdhënies së punës për lëshuar nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore e datës 30.04.2010, 1-3 faqe; Vërtetim i lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për e datës 20.09.2018; Vërtetim e lëshuar nga Fakulteti Filozofik, Shoqata e Historianëve të rinjë e datës 03.03.2004; Kontratë e lëshuar nga Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës për Letër reference e lëshuar nga Institute of World Archaeology (Ë.A.M) për Certificate of participation, lëshuar nga Institute of World Archaeology (Ë.A.M) për e datës 09.05.2003/ e përkthyer edhe në gjuhën shqipe; Certificate of participation, lëshuar nga Institute of World Archaeology (Ë.A.M) për Certifikatë Pjesëmarrjeje lëshuar nga Institute of World Archaeology (Ë.A.M) për Certifikatë Pjesëmarrjeje-Butint 2003 për Certifikatë e lëshuar nga IT Department LTD për A.Arifi e datës 02.10.2003; Certifikatë e lëshuar nga Komuna Kelmend, Tamarë, Malësi e madhe për e datës 10.08.2012; Certifikatë e lëshuar nga Rotary club, Prishtina International për e datës 12.12.2018; Katilim Belgesi e lëshuar nga T.C. Kultur ve turizm bakanligi, Ataturk kultur, dil ve tarih ve yuksek kurumu, Turk Tarih Kurumu për Certifikatë e lëshuar nga South-Ëest University " Neofit Rilski" Blagoevgrad, Bulgaria për e datës 30.10.2015; Certifikatë e lëshuar nga South-Ëest University " Neofit Rilski", Fakultety of Philosophy për A. Arifi e datës 11.11.2016; Certifikatë e lëshuar nga Instituti Albanologjik për e datës 17.06.2015; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti "Haxhi Zeka", Klubi i Intelktualëve të Rugovës për A. Arisi e datës 16.02.2019; Certifikatë e lëshua nga Akademia Profesionale Elita për e datës 23.02.2019; Shkresëe titulluar "Demonstratat e vitit 1968 në përbërje prej 2 faqe; Kopje e letërnjoftimit 2 faqe; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës për e datës 06.10.2017; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës për e datës 19.03.2019; Certifikatë e lëshuar për e datës 15.10.2018; Vërtetim i lëshuar nga Instituti i Historisë "Ali Hadri"- Prishtinë për e datës 13.03.2018; Vendim i lëshuar nga MKRS me nr.ref 4108/2019 e datës 26.09.2019 1-3 faqe; Ankesë drejtuar komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave nr.ref. 3900/2019 e datës 11.09.2019; Regjistri i aplikacioneve të pranuar nr.ref.25/2019; Vendim nr.ref.2624/2019 i datës 23.08.2019; Njoftim për anulimin e konkursit nr.ref.3623/2019 i datës 23.08.2019; Konkurs i hapur nga Ministria e Kulturës, Rinis dhe Sportit me nr.ref.25/2019; Shkresë e lëshuar nga MKRS "Përshkrimi i detyrave të punës", me nr.ref.2033/2019-02 e datës 23.05.2019 1-4 faqe; Kërkesë për fillimin e rekrutimit (punësimit) me nr.ref.2033/2019 e datës 23.05.2019; Njoftimin e Këshillit të datës 26.02.2020

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me gjatë administrimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi ka qenë pjesë e procesit të rekrutimit për pozitën e "Drejtorit të Muzeut Kombëtar të Kosovës", mirëpo ankuesi nuk ka qenë kandidati i suksesshëm. Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Sekretari i Përgjithshëm me datë 23.08.2019 ka nxjerrë vendimin me numër:1547/2019 përmes të cilit e ka anuluar procedurën e rekrutimit për pozitën e Drejtorit të Muzeut Kombëtar të Kosovës si dhe e ka shfuqizuar Vendimin me numër protokolli:3598/2019 të datës 22.08.2019 për emërimin e Drejtorit të Muzeut Kombëtar të Kosovës.



Kandidati i përzgjedhur me datë 11.09.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave kundër Vendimit me numër:1547/2019 të Sekretarit të Përgjithshëm me datës 23.08.2019, ndërsa Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me datë 26.09.2019 ka nxjerrë Vendimin KZKA Nr.20/2019 përmes të cilit e ka aprovuar pjesërisht ankesën e kandidatit të suksesshëm, ndërsa e ka anuluar Vendimin me numër protokoli:3624/2019 të datës 23.08.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën e Drejtorit të Muzeut Kombëtar të Kosovës.

Ankuesi, kundër përzgjedhjes së kandidatit të suksesshëm me datë 06.12.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa me datë 12.12.2019 Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka nxjerrë vendimin me numër KZKA Nr.28/2019 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të papranueshme për shkak që e njëjta është parashtruar jashtë afatit të paraparë kohor siç përcaktohet me dispozitat e Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave me arsyetimin se Komisioni në fjalë ndërlidhur me çështjen e përzgjedhjes së kandidatit ka vendosur përmes vendimit me numër protokoli:4108/2019 të datës 26.09.2019.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"* si dhe nenin 4 paragrafi 1 dhe neni 8 paragrafi 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjedhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: *"Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës"*, dhe ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve Ankesave i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me rastin e nxjerrjes së Vendimit më numër KA.nr.28/2019 të datës 12.12.2019 ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e lartcekura të ligjit pasi që ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit ndërlidhur me përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm respektivisht anulimin e konkursit janë parashtruar jashtë afateve kohore, ngase aktet, respektivisht Vendimi me numër protokoli:3598/2019 i datës 22.08.2019 për emërimin e kandidatit të suksesshëm si dhe Vendimin me numër protokoli:3624/2019 të datës 23.08.2019 të Sekretarit të Përgjithshëm të cilat akte lenë të kuptohet se ankuesi i ka goditur me ankesën e datës 06.12.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për të cilat pretendon se kanë qenë të kundërligjshme asaj kohe, nuk ka arritur të dëshmojë me prova se ndaj tyre ka parashtruar ankesë në kohën e nxjerrjes, respektivisht brenda afatit kohor prej 30 ditësh, pasi që me datë 23.08.2019 në faqen zyrtare të ministrisë ka qenë publik Njoftimi me numër:3623/2019 për anulimin e procedurës së rekrutimit, të cilit i referohet edhe vetë ankuesi në ankesën e tij, andaj mbi këtë bazë, ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 06.12.2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave është bërë jashtë afatit procedural të përcaktuara si në nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe ligjit material për goditjen tyre në procedurë administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana dhe në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.08/2020 e datës 13.01.2020

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Arkivoit të KPMSHCK- së.

